

## AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT

KODI I ETIKËS I FNK-të, SNKC-të, SNA-të, DIREKTIVAT E PRAKTIKAVE NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT, SNAR-të, SNAS-të DHE STANDARDEVE TË TJERA TË PUBLIKUARA NGA FNK, SI DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË PROFESIONIT TË EKR-të

### Teza me Përgjigjet - 2014

#### **SEKSIONI I : Pyetje me alternativa ( 1 PIKË SECILA)**

1. Pjesa C e Kodit të Etikës të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për profesionistët Kontabël (BSNEPK) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) i adresohet:
  - a) **Profesionistëve kontabël që e ushtrojnë profesionin në mënyrë të pavarur.**
  - b) Shoqërive të auditimit, pasi kërkon rregullimin e sjelljes së ortakëve të angazhimit.
  - c) Profesionistëve kontabël që punësohen në kompanitë e biznesit.
  - d) Të gjithë kategorive të profesionistëve, pavarësisht mënyrës se si e ushtrojnë profesionin.

#### **Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( a )

#### **2 .Cila nga alternativat më poshtë nuk do të përfshihët në letrën e angazhimit për një shërbim të rishikimit të pasqyrave financiare**

- a) Objektivi i shërbimit që duhet kryer.
- b) Përgjegjësia e Drejtimit lidhur me pasqyrat financiare.
- c) Referimin në Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit.
- d) **Fakti që nga angazhimi i rishikimit do të zbulohen gabime, veprime joligjore ose parregullsi të tjera,**

#### **Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( d )

#### **3. Cila prej procedurave të mëposhtme mund të përdoret nga audituesi për të siguruar njohjen e entitetit?**

- a) Marrja në pyetje e ekipit të auditimit.
- b) Rillogaritjet që bëhen nga audituesi në lidhje me efektet e transaksioneve.
- c) **Procedurat analitike.**
- d) Vëzhgimi e inspektimi.

#### **Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( c )

**4. Audituesit e shoqërive jo-publike (që nuk janë të listuara në bursë) duhet të kryejnë një test të efektivitetit të funksionimit të një kontrolli të rëndësishëm :**

- a) Në të gjitha llojet e auditimeve.
- b) Kur kontrolli ka të bëjë me një aktiv të rëndësishëm.
- c) **Kur procedurat thelbësore të vetme nuk japin evidencën e mjaftueshme rreth pohimit përkates.**
- d) Kur audituesit besojnë se kontrolli mund të mos jetë efektiv.

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( c )

**5. Zgjedhja e kampionit për auditim (sample size) përbën:**

- a) Një nr transaksionesh që shërbejnë për testim në zonat e rëndësishme të pasqyrave financiare me qëllimin përfundimtar për të formuar një opinion për pasqyrat financiare.
- b) Një nr transaksionesh që shërbejnë për të testuar kontrollet e brendshme.
- c) Një nr transaksionesh që përdoren për të matur rriskun që ndërrmer një kompani gjatë operacioneve të saj.
- d) **A & B.**

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( d )

**6. Zgjedhja e metodës midis auditimit të sistemeve dhe auditimit të transaksioneve varet nga:**

- a) Natyra e biznesit dhe Industria ku vepron.
- b) Kompleksiteti i biznesit.
- c) Risqet që ajo ndërmerr dhe sistemet e manaxhimit të risqeve.
- d) **A, B & C.**

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( d )

**7. Zakonisht instruksionet e hartuara nga audituesi i grupit nuk përmbajnë:**

- a) Politikat kontabël të aplikueshme.
- b) Paraqitjet shtesë të kërkuara nga ligjet në fuqi të vendit e rezidencës së audituesit të grupit.
- c) Afatet e dorëzimit të raportit.
- d) **Strategjinë e auditimit që duhet të ndjekë audituesi i komponentit.**

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( d )

**8. Përpara se të pranojë një angazhim për të raportuar mbi pasqyrat financiare përmbledhëse audituesi duhet të:**

- a) Përcaktojë nëse kriteri i përdorur është i pranueshëm.
- b) Dakordojë me drejtimin përgjegjësive të audituesit për përgatitjen e pasqyrave financiare përmbledhëse.**
- c) Dakordojë me drejtimin formën e opinionit që do të lëshohet.
- d) Të jetë auditues i pasqyrave financiare të kompanisë të përgatitura në përputhje me SNRF-në.

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( b )

**9. Një Ekspert Kontabël i Autorizuar (EKR) pa se klienti nuk kishte kapitalizuar një shumë materiale qeraje në pasqyrat financiare. Kur shqyrtoi materialitetin e kësaj shmangie nga standardet kontabël, opsionet e raportimit të EKR-së ishin:**

- a) Opinion i pakualifikuar ose mosdhënie opinionit.
- b) Opinion i pakualifikuar ose opinion i kualifikuar.
- c) Paragraf theksimi me opinion të pakualifikuar ose opinion të kundërt.
- d) Opinioni i kualifikuar ose opinion i kundërt.**

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( d )

**10. Cfare raporti auditimi mund të lëshohet nëse një njësi ekonomike përgatit pasqyrat financiare të përmbledhura:**

- a) Opinion standard
- b) Nuk jepet opinion
- c) Raport rishikimi**
- d) Asnjë nga të mësipërmet

**Përgjigja e saktë:**

Alternativa ( c )

## **SEKSIONI II: Organizimi i Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar**

### **1.**

	<b>A parashikon Ligji nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistëve të miratuar,” dispozita që rregullojnë veprimtaritë e mëposhtëme apo jo? (4 pikë)</b> (Shëno me kryq kutinë e “Po” nëse mendoni se veprimtaria përkatëse është e rregulluar nga ky Ligj, në të kundërt shëno me kryq kutinë “Jo”.)	<b>PO</b>	<b>JO</b>
<b>a.</b>	Përgatitjen e pasqyrave financiare individuale...		X
<b>b.</b>	Përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara ...		X
<b>c.</b>	Organizimin e profesionit të këshilltarëve fiskalë		X
<b>d.</b>	Auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore	X	
<b>e.</b>	Organizimin e profesionit të ekspertit kontabël	X	
<b>f.</b>	Organizimin e shoqërive të auditimit	X	
<b>g.</b>	Rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit	X	

### **2.**

<b>01.</b>	<b>Sipas përkufizimit të parashikuar në Ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të EKR-ve ...” në Nenin 2, paragrafi 7, a përfshin apo jo ky përkufizim i termit “Ekspert Kontabël i Regjistruar” cilësitë e mëposhtëme? (4 pikë)</b> (Shëno me kryq kutinë e “Po” nëse mendoni se përfshihen, në të kundërt shëno me kryq kutinë “Jo”.)	<b>PO</b>	<b>JO</b>
<b>a.</b>	Është profesionit i pavarur	X	
<b>b.</b>	Është antar edhe i ndonjë organizate tjetër profesionale		X
<b>c.</b>	Është i regjistruar në regjistrin publik të EKR-ve	X	
<b>d.</b>	Ushtron profesionin për auditimin ligjor të pasqyrave financiare	X	
<b>e.</b>	Kryen shërbime të rishikimit të informacionit financiar historik e të dhënies së sigurisë për informacionet financiare dhe shërbimet e lidhura	X	
<b>f.</b>	Kryen shërbime që nuk kanë lidhje me raportimin financiar apo me informacionet financiare historike		X
<b>g.</b>	Ka mbaruar shkollën e lartë, ose thënë ndryshe ka mbaruar arsimin universitar në degët e ekonomisë dhe biznesit, ose degë të barazvleshme me to.		X

### **SEKSIONI III: Etika Profesionale**

1. Në qoftë se një klienti, të cilit i auditohen pasqyrat financiare, gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, por përpara se të fillohen shërbimet profesionale që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, i është dhënë një shërbim i jo-sigurisë (që nuk ka të bëjë me dhënien e sigurisë), dhe ky shërbim ndalohej të jepet gjatë periudhës së angazhimit të auditimit, atëherë duhet të mbahen parasysh kërcënimet ndaj pavarësisë, po qe se ka të tilla, të cilat lindin nga ky shërbim. Tregoni shkurtimisht se cilat janë masat e nevojshme mbrojtëse që duhet të merren parasysh dhe të zbatohen në qoftë se kërcënimi nuk është krejt i parëndësishëm. Argumentoni efektin e këtyre masave mbrojtëse. **(4 pikë)**

#### **Përgjigja:**

Masat mbrojtëse mund të jene :

- Diskutimi i çështjeve të pavarësisë që i përkasin dhënies së shërbimeve, të cilat janë të ndryshme nga shërbimet e sigurisë, me personat që janë ngarkuar me qeverisjen e klientit, siç është komiteti i auditimit; **(1 pikë)**
- Marrja e sigurisë që klienti e pranon përgjegjësinë në lidhje me pasojat që rrjedhin nga kryerja prej firmës e shërbimit të jo-sigurisë; **(1 pikë)**
- Moslejimi i personelit, që ka dhënë një shërbim të jo-sigurisë, për të marrë pjesë edhe në angazhimin e auditimit të pasqyrave financiare; dhe **(1 pikë)**
- Angazhimi i një firme tjetër për të rishikuar rezultatet e shërbimit të jo-sigurisë ose angazhimi i një firme tjetër që të rikryejë këtë shërbim deri në atë shkallë që i jep mundësi asaj të marrë përgjegjësinë për shërbimin. **(1 pikë)**

Keto masa kane per qellim te zvogëlojne kërcënimin në një nivel të pranueshëm.

2. Eksperti kontabel i autorizuar AD e ka pare te arsyeshme te lidhe nje marreveshje sherbimi me nje klient me objekt dhenien e konsulences kontabel e tatimore. Ne te vertete per kryerjen e ketij sherbimi ai merr nje post pune ne zyrat e kleintit dhe qendron tek ai ne menyre te perhershme sikur te ishte nje i punesuar i tij. Nga ana tjetere, ai pergatit dokumentacionin e perditshem per nevojat e kleintit, ben regjistrimet kontabel dhe harton raportet financiare per organet e drejtimit te klientit. **(5 pikë)**
  - A duhet qe eksperti kontabel i autorizuar te veproje ne kete menyre? Cilat jane rreziqet e nje angazhimi te tille? – Argumentoni pergjigjen duke treguar edhe masat mbrojtëse te nevojshme qe duhet te ndermerren en kete rast

### **Përgjigja:**

EKR nuk duhet të qendrojë tek klienti në mënyrë të përhershme, dhe njëkohësisht të përgatise dokumentacionin e përditshëm për nevojat e klientit si dhe bëjë të gjitha regjistrimet kontabel dhe të hartojë raportet financiare për organet e drejtimit, kjo pasi bie ndesh me të objektin e marrëveshjes së shërbimit të lidhur midis palëve. **( 0.5 pikë)**

Kjo situatë mund të shkaktojë disa kërçenime njëkohësisht disa prej të cilave mund të jenë:

*Kërçenimi i familjaritetit* e cila mund të shfaqet për shkak të marrëdhënies së gjatë ose të afërt me klientin në të cilin EKR ka lidhur kontratën e shërbimit dhe njëkohësisht qëndron me zyrë tek klienti duke përgatitur dokumentacionin e përditshëm. **( 1 pikë)**

*Kërçenimi i egoizmit* icili do të influencojë në mënyrë të papershtashme gjykimin dhe sjelljen profesionale të profesionistit kontabel. **( 1 pikë)**

*Kërçenimi i vetë-rishikimit*, pasi EKR i përgatit vetë dokumentacionet dhe njëkohësisht është edhe konsulent kontabel dhe tatimor kjo pasi mund të shkaktojë faktin që ai të mos vlerësojë siç duhet rezultatet e gjyqimeve të mëparshme të bëra prej tij ose të shërbimeve të kryera prej tij ose edhe nga ndonjë individ tjetër brenda firmës (klientit) mbi të cilin profesionisti kontabel do të mbështetet kur ai formon një gjykim që është pjesë e dënies së shërbimit. **(1 pikë)**

*Kërçenimi i përkrhjes* pasi mund të ndodhë që EKR të stimulojë poziten e klientit deri në atë pikë sa të kompromentohet objektiviteti i tij. **( 1 pikë).**

Për sa më lartë duhet të të merren disa masa mbrojtje sidomos ato që lidhen me mjedisin e punës dhe që variojnë në varesi të rrethanave të trajtuara. Këto masa janë të trajtuara respektivisht në pjesa B dhe C të Kodit të punës. Kur ushtron gjykimin profesional EKR duhet të mbajë parasysh atë çka do të konkludonte si të papranueshme një palë e tretë e arsyeshme, e cila ka njohuri si për informacionet ashtu edhe për rëndësinë e kërçenimeve dhe të masave mbrojtëse që zbatohen. **( 0.5 pikë)**

## **SEKSIONI IV: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit**

1.

	<b>SNA 200 – Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e Auditimit në Pajtim me SNA-të (4 pikë)</b> Përgjigju pyetjeve në rreshtin bosh poshtë secilës pyetje.
<b>a.</b>	Si arrihet qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit?
	<b>Përgjigja:</b> Qëllimi i auditimit arrihet duke shprehur një opinion nga audituesi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
<b>b.</b>	Kush është qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit?
	<b>Përgjigja:</b> Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit është të rrisë shkallën e besimit tek përdoruesit e synuar për këto pasqyra.
<b>c.</b>	Cili është kriteri (apo kriteret) nëpërmjet të cilave audituesi përcakton se pasqyrat financiare japin një pamje të vertetë dhe të sigurtë në të gjitha aspektet materiale?
	<b>Përgjigja:</b> Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.
<b>d.</b>	Mbi çfarë baze kryhet angazhimi i auditimit të pasqyrave financiare?
	<b>Përgjigja:</b> Auditimi kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të gjitha kërkesat përkatëse të etikës.
<b>e.</b>	Kush ka përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare të entiteti?
	<b>Përgjigja:</b> Pasqyrat financiare të entitetit subjekt i auditimit, përgatiten nga drejtimi i entitetit nën mbikqyrjen e atyre që janë ngarkuar me qeverisjen.

## 2.

	<p><b>SNA 200 – Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e Auditimit në Pajtim me SNA-të (4 pikë)</b> Përgjigju pyetjeve në rreshtin bosh poshtë secilës pyetje .</p>
a.	<p>A i shkarkon nga përgjegjësia e tyre drejtuesit e entitetit për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, auditimi i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit? Pse?</p>
	<p><b>Përgjigja:</b> Auditimi i pasqyrave financiare të entitetit bazuar në SNA-të nuk e shkarkon drejtimin e entitetit nga përgjegjësia për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Sepse qëllimi i auditimit është të japë një opinion dhe jo të përgatisë pasqyrat financiare.</p>
b.	<p>Kush është qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit?</p>
	<p><b>Përgjigja:</b> Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit është të rrisë shkallën e besimit tek përdoruesit e synuar për këto pasqyra.</p>
c.	<p>Cili është kriteri (apo kriteret) nëpërmjet të cilave audituesi përcakton se pasqyrat financiare japin një pamje të vertetë dhe të sigurtë në të gjitha aspektet materiale?</p>
	<p><b>Përgjigja:</b> Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.</p>
d.	<p>Mbi çfarë baze kryhet angazhimi i auditimit të pasqyrave financiare?</p>
	<p><b>Përgjigja:</b> Auditimi kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të gjitha kërkesat përkatëse të etikës.</p>
e.	<p>Si arrihet qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare të entitetit?</p>
	<p><b>Përgjigja:</b> Qëllimi i auditimit arrihet duke shprehur një opinion nga audituesi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.</p>



### 3. Shpjego çfarë është rreziku i auditimit dhe komponentët e tij. (4 pikë)

#### **Përgjigja:**

Rreziku i auditimit është rreziku që audituesit të japë një opinion të papërshtatshëm kur pasqyrat financiare kanë gabime materiale. Rreziku i auditimit është një funksion i 2 komponenteve kryesor që janë rreziku i gabimit material dhe rreziku i zbulimit. Rreziku i gabimit material përbëhet nga 2 komponentë, rreziku i brendshëm dhe rreziku i kontrollit.

Rreziku i brendshëm është dyshimi që një pohim për një kategori transaksioni, gjendje llogarie apo paraqitje në PF të ketë gabime që mund të jenë materiale, individualisht ose nëse bashkohen me gabime të tjera, përpara se të konsiderohen kontrollet që kanë lidhje me to.

Rreziku i kontrollit është rreziku që një gabim i cili mund të ndodh në një pohim në lidhje me një kategori transaksioni, gjendje llogarie apo paraqitje dhe i cili mund të jetë material, individualisht ose nëse bashkohet me gabime të tjera, nuk do të ndalohej, ose të zbulohet dhe korrigjohet, në kohën e duhur nga kontrolli i brendshëm i shoqërisë.

Rreziku i moszbulimit është rreziku që procedurat e kryera nga audituesi për të ulur rrezikun e auditimit në një nivel të pranueshëm të ulët nuk do të zbulojnë një gabim i cili ekziston dhe mund të jetë material, individualisht ose nëse bashkohet me gabime të tjera.

Rreziku i moszbulimit ndikohet nga rreziku i kampionit dhe pjesës jashtë kampionit.

### 4. Pasqyrat financiare të shoqërisë Beta sh.p.k. kanë disa zëra të pasqyrave financiare të cilat janë vlerësuar me vlerën e drejtë. Për ju si EKR i kësaj shoqërie ky fakt sjell një rrezik të shtuar auditimi.

- Diskutoni këtë përcaktim duke identifikuar komponentët e rrezikut. (5 pikë)

#### **Përgjigja:**

Rreziku i auditimit është produkt i rrezikut të brendshëm, rrezikut të kontrollit dhe rrezikut të moszbulimit dhe ndikimi i llogarive me vlera materiale të njohura me vlerën e drejtë për çdo rrezik është paraqitur më poshtë:

Rreziku i brendshëm (2 pikë)

Matjet me vlerë të drejtë janë vetëvetiu subjektive si natyrë dhe ato zakonisht kryhen duke bërë parashikime bazuar në një numër presupozimesh. Drejtimi mund të mos jetë mjaftueshëm me eksperiencë ose të ketë njohuritë të për bërë këto presupozime. Presupozimet gjithashtu mund të manipulohen nga individë në mënyrë që të kenë vlerën e drejtë më të favorshme për ta në pasqyrat financiare, me fjalë të tjera mund të mashtrojnë.

Llogaritja e vlerës së drejtë është komplekse për shumë llogari. Psh, llogaritje me aktuale për fondet e pensioneve. Kjo i bën ato vetvetiu më të vështira për t'u audituar sepse mundësia e gabimit është më e lartë në llogaritjet komplekse.

Rreziku i Kontrollit 1,5 pikë

Matjet me vlerë të drejtë nuk janë transaksione rutinë dhe ka gjasa që të ndodhin vetëm një herë në vit. Ato rrjedhimisht ka shumë mundësi që të mos jenë subjekt i kontrollit të ngritur nga shoqëria për transaksionet që ndodhin zakonisht. Kjo e rrit mundësinë që kontrollet ndaj tyre të mos jenë kaq të forta sa janë për ngjarje rutine.

Rreziku i moszbulimit 1,5 pikë

Rreziku i zbulimit mund të minimizohet nëpërmjet një planifikimi të mirë të punës audituese. Ekziston një rrezik që ekipi i auditimit i vetëm të mos ketë njohuritë për të kryer një vlerësim të matjes me vlerë të drejtë dhe të bazohet kryesisht në punën e një eksperti të audituesit. Kjo mund të rezultojë në një rrezik të rritur për moszbulimin e gabimeve.

5. Ju jeni caktuar si EKR për auditim në spitalin Higjena. Spitali ka investuar në pajisje të reja kirurgjike, që edhe pse shumë të shtrenjta kanë pasur si qëllim përmirësimin e shërbimit. Megjithatë, për momentin ka një mungesë stafi të kualifikuar dhe të trajnuar. Një komitet për shpenzimet kapitale është ngritur dhe ata planifikojnë të autorizojnë çdo shpenzim të rëndësishëm kapital.

- Përkrahë 2 procedurë thelbësore që ju si auditues i spitalit duhet të keni për të verifikuar pohimin e vlerësimit të aktiveve. **(5 pikë)**

### **Përgjigja:**

Duke qenë se ka një rrezik që në kushtet që pajisjet janë blerë shumë të shtrenjta (mbi vlerën e tregut) dhe përdorimi i tyre si pasojë e mos-kualifikimit mund të shkurtojë jetën e dobishme të tyre, pohimi i vlerësimit për këto pajisje vlerësohet të ketë një rrezik të lartë. Procedurat thelbësore për pohimin e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (AAM) mund të jenë 2 prej këtyre me poshtë:

- Rishiko politiken e amortizimit nëse është e arsyeshme dhe krahasoje me vitin parardhës dhe normat që zbatohen në atë industri. Rishiko politiken e zëvendësimit të pajisjeve që zbaton shoqëria. Rishiko ekzistencën e fitimeve humbje nga shitja e AAM-ve dhe arsyeto për normat e amortizimit.
- Për një shembull aktivesh rillogarit shpenzimin e amortizimit për vitin dhe rakordo këto vlera me atë që është në regjistrin e AAM-ve
- Kryej një llogaritje për totalin e amortizimit (si një procedurë analitike thelbësore) duke konsideruar kohën e sheshtë dhe pakesimeve gjatë vitit dhe krahaso rezultatin me shpenzimin e amortizimit, dhe investigo ndonjë diferencë të rëndësishme.

- Nëse ka ndonjë AAM që është rivekuruar gjatë vitit atëherë vlerëso arsyeshmërinë e vlerësuesit. Në veçanti konsidero eksperiencën, pavarësinë, qëllimin e punës dhe presupozimet e përdorura nga vlerësuesi.
- Rëkordet e vlerësuar të AAM me raportin e vlerësimit. Për një shembull AAMve rilllogarit plusvlerën dhe rëkordoje me rezervën e rivekurimit.
- Për një shembull të shtesave në pajisjet mjeksore kontrolloni koston e tyre me fakturën e blerjes.

**Cdo procedurë 2,5 pikë; gjithsej 5 pikë**

**6. Tregoni dy shembuj të rasteve kur kërkohet të bëhet konfirmimi i llogarive të pagueshme. (4 pikë)**

**Përgjigja:**

Rastet janë si më poshtë:

- Rasti i I-re është kur një balancë e llogarive të pagueshme është një furnitor i rëndësishëm me të cilin kompania nën proces auditimi dhe ka pasur një nivel të konsiderueshëm dhe material transaksionesh tregtare me të. Konfirmimi duhet të bëhet me deklaratë me shkrim për shumën e transaksioneve dhe balancën në fund të periudhës që auditohet.
- Rasti i dytë është një llogarë i pagueshëm e cila nuk ka balancë materiale (mund të jetë shumë insignificant) por kjo është një balancë me një "Palo të lidhur" me kompaninë dhe verifikimi dhe raportimi i transaksioneve dhe balancave është shumë i rëndësishëm në raport.

**7. Listoni 5 qëllime kryesore të ekzistencës së fletëve të punës së auditimit. (5 pikë)**

**Përgjigja:**

**Qëllimet kryesore të ekzistencës së fletëve të auditimit janë si më poshtë:**

- Baza për planifikimin e auditimit: dokumentimi i pasqyrave financiare të klientit bashkë me analizën e audituesit shërbejnë për planifikimin e auditit, analizë të riskut, zonat me fokus me të lartë dhe manaxhimi i burimeve njerezore për këtë proces,
- Rëgjistimi dhe dokumentimi i evidencës që bëri të mundur auditimin dhe dokumentimi për rezultatet e auditimit për çdo zonë materiale të pasqyrave financiare dhe përfundimisht për të mbështetur dhe opinionin e Audituesit.
- Letrat e punës përmbajnë të dhënat dhe analizat e nevojshme për të përcaktuar llojin e auditimit që do kryhet, pra do të jetë një auditim i fokusuar tek testimi i kontrolleve dhe pa procedurë substantive apo e kundërta,
- Letrat e punës bëjnë të mundur procesin e rishikimit nga nivelet drejtuese si partnerët e auditimit dhe manaxherët për të siguruar një proces auditimi sa më cilësor sipas standarteve të përcaktuara në linjën e kryerjes së një auditimi dhe aprovimi të tij,

- Letrat e punes konfirmojne se si eshte kryer nje auditim, ne cfare cilesie dhe ne perputhje ose me standartet e aprovuara te Auditimit
- 8.** Si mendoni kush eshte me me rendesi per audituesin, te fokusohet per nje testim me te madh te kontrolleve te subjektit dhe pak rishikim dokumentacioni apo rishikimi sa me i madh i evidences se veprimtarise se tij dhe ti kushtoje me pak kohe testimit te kontrolleve. **(5 pikë)**

**Përgjigja:**

Rendesia e zhvillimit te procesit te auditimit dhe cilesia e rezultatit varen nga nje kombinim i procesit si ne testimin e kontrolleve dhe performimin e procedurave substantive pra ne rishikimin e dokumentacionit te njesise nen Auditim. Ne varesi te analizes se risqeve, Audituesi pervec testimit te kontrolleve mund hd duhet te kryerje dhe rishikim te transaksioneve bazuar ne nje perzgjedhje te caktuar dhe madhesi te caktuar. Vetem funksionimi i kontrolleve nuk perben evidence definitive per sigurine e procesit dhe dhenien e nje opinionit nga Audituesi.

- 9.** Audituesi i grupit duhet t'i kërkojë audituesit të komponentit që t'i komunikojë çështje që lidhen me konkluzionet ku do të bazohet raporti i audituesit. Listoni minimumi 4 çështje që duhet të përmbaje ky komunikim. **(4 pikë)**

**Përgjigja:**

Çështjet që duhet të përmbajë ky komunikim janë si më poshtë;

- o Nëse audituesi i komponentit ka vepruar në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante për audituesin e grupit, duke përfshirë pavarësisë dhe kompetencës profesionale;
- o Nëse audituesi i komponentit ka vepruar në pajtueshmëri me kërkesat e audituesit të grupit;
- o Identifikimi i informacioneve financiare të komponentit mbi të cilat audituesi i komponentit është duke raportuar;
- o Të dhëna mbi rastet e mosrespektimit të ligjeve ose rregullave që mund të sjellin gabime materiale të pasqyrave financiare të grupit;
- o Një listë të gabimeve të pakorrigjuara të informacionit financiar të komponentit (lista nuk ka nevojë të përfshijë anomalitë që janë nën pragun e gabimeve të lejuar të komunikuar nga audituesi i grupit);
- o Treguesit e devijimeve të mundshme të informacionit financiar nga ana e drejtimit të shoqërisë;
- o Përshkrimi i ndonjë mangësie të rëndësishme të identifikuar në kontrollin e brendshëm të komponentit;

- Çështje të tjera të rëndësishme që audituesi i komponentit i ka komunikuar ose pret që t'ia komunikojë palëve të ngarkuara me qeverisjen e komponentit, duke përfshirë mashtrim ose mashtrim të dyshuar lidhur me drejtimin e komponentit, punonjës të cilët kanë rol të rëndësishëm në kontrollin e brendshëm të komponentit ose raste të tjera në të cilat mashtrimi rezultoi në një gabim materiale në pasqyrat financiare të komponentit;
- çështje të tjera që mund të jenë relevante për auditimin e grupit, ose që audituesi i komponentit dëshiron t'i nxjerrë në vëmendje të audituesit të grupit, duke përfshirë edhe çështje të vendosura në letrën e përfaqësimit të cilën audituesi i komponentit e ka marrë të nënshkruar nga drejtimi i komponentit; dhe
- Opinionin dhe konkluzionet e përgjithshme që rrjedhin nga puna e audituesit

Në rast se ka listuar 4 nga pikat e mësipërme, merr pikët e plota

**10.** Ju jeni manaxheri i auditimit të grupit Korabi, kompanitë e së cilës merren me prodhimin e vajit në vende të ndryshme të rajonit. Partneri i angazhimit ju ka nisur e-mailin e mëposhtëm

Ne jemi riemeruar si auditues për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 201X I grupit Korabi dhe jam njoftuar që me 30 nëntor 201X kompania ka blerë kompaninë Korabi1 për një vlerë prej EUR 1,500,000 dhe emri i mirë që lind nga ky transaksion është 500,000 EUR. Kompania operon në Kosovë dhe monedha funksionale e saja është EUR. Kursi i këmbimit EUR:LEK është 1;140. Kompania raporton humbje të akumuluar 700,000 EUR dhe linja e prodhimit që përdoret për prodhimin e vajit është jashtë standardit të grupit.

- Përgatisni rreziqet e identifikuara në auditimin e komponentit Toy1 dhe përshkruani metodologjinë për testimin e emrit të mirë. **(5 pikë)**

### **Përgjigja:**

Rreziqet e identifikuara në auditimin e komponentit Korabi1, bazuar në informacionin që na është vënë në dispozicion janë si më poshtë (cdo rreziq një pikë);

- Rreziku i rëndësishëm që vlera e fabrikës së vajit të jetë e mbivlerësuar – Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara;
- Rreziku i rëndësishëm që një test për zhvlerësimin e vlerës së fabrikës së vajit të mos jetë kryer - Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe llogaria e humbje nga zhvlerësimi;
- Rreziku i rëndësishëm që kompania mund të ketë vështirësi financiare të cilat mund të shkaktojnë probleme për vazhdimësinë e kompanisë në të ardhmen;

Emri i mirë në llogaritë kontabël të kompanisë mëmë llogaritet si diferencë e investimit dhe kapitalit neto të shoqërisë. Duke patur parasysh që kompania po operon me humbje të akumuluar dhe linja e prodhimit përdoret për prodhimin e vajit është jashtë standardit të

grupit, atëherë ka *indikacione të forta që vlera e emrit të mirë të jetë zhvlerësuar*. Për këtë qëllim kompania duhet të testojë këtë emër të mirë për zhvlerësim. Në cilësinë e audituesit ne duhet të marrim *kopje të këtij testimi*. Testi i zhvlerësimit duhet të përfshijë parashikimet e flukseve të pritshme të parasë që kompania Korabi1 prit të gjenerojë. Menyra e testimit do të *jetë testim në detaje*. Duke qënë se rishikimi i testit të zhvlerësimit është një komponent që kërkon ekspertizën e një vlerësuesi dhe audituesi vetë nuk e ka këtë lloj ekspertize, SNA-të rekomandojnë *përfshirjen e një eksperti* për rishikimin e këtij testi.

Në rast se kompania Korabi1 nuk pranon të kryejë një test zhvlerësimi dhe çështja është materiale, atëherë çështja adresohet në opinionin e audituesit të pavarur.

(Frazat me italice janë pika kyce për t'u përmendur) **2 pikë**

**11.** Ju jeni emëruar si auditues ligjor dhe auditues për qëllime të raportimit tek grupi I njërit prej komponentëve të grupit TIA. Audituesi i grupit ka përcaktuar nivelin e materialitetit për komponentët në vlerën e EUR 300,000 dhe niveli i gabimit të lejuar EUR 4,200. Niveli i materialitetit të përcaktuar nga audituesi i komponentit për qëllime të raportimit statutor është EUR 22,000 dhe niveli i gabimit të lejuar është EUR 300. Audituesi i komponentit ka identifikuar një provigjion për klientët të paregjistruar nga klienti në vlerën 50,000 EUR, vlerë të cilën drejtimi i kompanisë nuk pranon ta regjistrojë. Komentoni se cili është efekti i mosregjistrimit të këtij veprimi në raportin e audituesit të lëshuar nga audituesi i komponentit, si për qëllime të auditimit ligjor edhe për qëllim të raportimit tek audituesi i grupit. **(5 pikë)**

### **Përgjigja:**

Në rastet kur audituesi i komponentit përgatit raportin e auditimit për qëllim të raportimit tek audituesi i grupit, vlera prej EUR 50,000 është *nën nivelin e materialitetit të grupit dhe mbi nivelin e gabimit të lejuar*. Si e tillë audituesi *nuk e adreson këtë çështje në opinionin e tij, por e raporton tek Përbledhësja e gabimeve të lejuara e të pakorrigjuara dhe e shton si gabim të pakorrigjuar në letrën e përfaqësimit*. Gjithashtu mqs kjo vlerë është materiale për qëllime statutore, atëherë ky fakt duhet të *përmendet në konkluzionet përfundimare* që dergohen tek audituesi i grupit. 3 pikë. (Frazat me italice janë pika kyce për t'u përmendur).

Për qëllime të raportimit statutor shuma prej EUR 50,000 është *materiale* dhe moskorrigjimi i saj nga ana e drejtimit, është *shkak për kualifikimin e opinionit të audituesit* për mosdakordësi me drejtimin e shoqërisë. 2 pikë. (Frazat me italice janë pika kyce për t'u përmendur).

**12. Cfare eshte nje refuzim dhenie opinion auditimi? Nga ndryshon ai nga nje opinion i kundert auditimi? (4 pikë)**

**Përgjigja:**

**Refuzimi për të dhënë opinion (1 pikë)**

Audituesi duhet të refuzojë dhënien e një opinionin kur ai nuk është në gjendje të marrë evidencën e nevojshme të auditimit mbi të cilën të mbështesë opinionin dhe audituesi arrin në përfundimin se ndikimet e mundshme në pasqyrat financiare të anomalive të pazbuluara, nëse do të kishte të tilla, mund të jenë materiale dhe të përhapura. Audituesi duhet të refuzojë të japë një opinion kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë paqartësi të shumta, audituesi arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që ai ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me secilën nga pasiguritë individuale, nuk është e mundur që ai të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare për shkak të ndërveprimit të mundshëm të pasigurive dhe efekteve kumulative të mundshme të tyre në pasqyrat financiare

**Opinionin kundër (1 pikë)**

Audituesi duhet të shprehë një opinion kundër kur ai, pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomalitë në pasqyrat financiare, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura/pervasive.

Karakteristikat dhe dallimet e lëshimit të një Opinioni Kundër ose Refuzimit të Dhënies së Opinioni përcaktohen në **SNA 750 'Modifikimet e opinionit në raportin e audituesit të pavarur'**. (0.5 pikë)

Dallimet kryesore mes këtyre dy llojeve të modifikimeve të opinionit qëndrojnë në këto pika kryesore:

1. Natyrën e anomalive materiale të evidentuara gjatë procesit të auditimit; (0.5 pikë)
2. Përshkrimin e përgjegjësisë së audituesit (0.5 pikë)
3. Paragrafin e dhënies së opinionit (0.5 pikë)

Nr.	Karakteristika	Opinionin kundër	Refuzimi për të dhënë opinion
1	<b>Natyra e anomalisë materiale të evidentuar</b>	Audituesi, pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomalitë në pasqyrat financiare, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.	Audituesi nuk është në gjendje të marrë evidencën e nevojshme dhe te mjaftueshme të auditimit mbi të cilën të mbështesë opinionin dhe audituesi arrin në përfundimin se ndikimet e mundshme në pasqyrat financiare të anomalive të pazbuluara, nëse do të kishte të tilla, mund të jenë materiale dhe të përhapura.

2	<b>Paragrafi i Përshkrimit të përgjegjësisë së audituesit</b>	“...evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin e auditimit të modifikuar.”	“Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion në këto pasqyra financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Megjithatë, për shkak të çështjes(ve) të përshkruara në paragrafin e bazës për refuzimin e opinionit, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit.”
3	<b>Paragrafi i dhënies së opinionit</b>	“Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin kundër, pasqyrat financiare nuk paraqesin në nënryrë të drejtë pozicionin financiar të kompanisë X në datën 31 Dhjetor 20XX, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.”	“Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për refuzimin e dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare.”

**13.** Kompania ABC shpk po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur me 31 dhjetor 2013. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me SNRF dhe kompania nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Pasqyrat financiare përfshijnë: Bilancin Kontabel, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në Kapital dhe Pasqyrën e Levizjes së Flukseve Monetare.

Audituesve të jashtëm u kërkohej që të raportojnë për pronarët e kompanisë për vitin financiar të mbyllur me 31 dhjetor 2013. Gjate punës inspektuese audituesit evidentojnë se drejtimi i ABC shpk ka vlerësuar inventarin me kosto dhe jo me vlerën me të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme (e cila kërkohej nga IAS 2 “Inventaret” – paragrafi 9). Materialiteti i audituesve i përcaktuar është për 31 dhjetor 2013 është 10 mln leke. Inventari në Bilanc për 31 dhjetor 2013 është 12 mln leke ndërsa në 31 dhjetor 2012 është 7 mln leke.

**Pyetje:**

- Përcaktoni se çfarë tipi opinionit do të leshojnë audituesit drejtimit? Çfarë do të shkruhet në paragrafin e tyre të raportit të auditimit? ? (5 pikë)



### **Përgjigja:**

Meqenese inventari = 12 mln Leke eshte me i madh se Materialiteti = 10 mln leke, anomalia eshte materiale (0.5 pikë) po jo pervasive ose e perhapur (0.5 pikë). Tipi I opinionit qe do te leskohet nga audituseit do jete Opinionit me reserve (0.5pikë).

*Baza për opinionin me rezervë:*

Inventarët e kompanisë në bilancin kontabël paraqiten në vlerën 12 mln Lekë. Drejtimi nuk ka vlerësuar inventarët me vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme, por vetëm me kosto, e cila përbën një shmangie nga SNRF. (0.5 pikë). Mbështetur në regjistrimet e kompanisë, në qoftë se drejtimi do të kishte vlerësuar inventarët me vlerën më të vogël mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme, një shumë prej xxx Lekë do të kërkohej për të vlerësuar inventarët me vlerën neto të realizueshme.(0.5 pikë). Gjithashtu, kosto e shitjes do të rritej (0.5 pikë) me xxx Lekë, si dhe tatim fitimi (0.5 pikë), të ardhurat neto dhe kapitali i pronarit do të ishin zvogëluar (0.5 pikë) me xxx Lekë, xxx Lekë dhe xxx Lekë respektivisht..

### **Opinionit me rezervë: (0.5 pikë)**

Sipas opinionit tonë, me përrjashtim të efekteve të ceshties së përshkruar në paragrafin e bazës për opinionin me rezerve, (0.5 pikë), pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjithë aspektet (0.5 pikë) të pozicionit financiar të ABC shpk në datën 31 Dhjetor 2013, të performancës financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*\*\*\*Shenim: Vlera prej xxx leke nuk eshte dhene persa kohe nuk eshte percaktuar vlera e re dhe e saktë e inventarit me date 31.12.2013.*

**14.** Kompania ABC shpk po pergatit pasqyrat financiare per vitin financiar te mbyllur me 31 dhjetor 2013. Pasqyrat financiare duhet te pergatiten ne perputhje me SNRF dhe kompania nuk aplikon ndonje ligj apo rregullore tjeter lokale. Pasqyrat financiare perfshijne: Bilancin Kontabel, Pasqyren e te Ardhurave Gjitheperfshirese, Pasqyren e ndryshimeve ne Kapital dhe Pasqyren e Levizjes se Flukseve Monetare. Audituesit e jashtem kerkohet qe te raportojne per pronaret e kompanise per vitin financiar te mbyllur me 31 dhjetor 2013. ABC shpk ka nje investim ne nje siper marrje te perbashket, kompanine XYZ, i llogaritur per perdorimin e konsolidimit proporcional, ne perputhje me SNA 31 "Interesat ne siper marrjet e perbashketa". Per shkak te nje renieje te biznesit, aktivet neto te ABC shpk jane ne menyre te konsiderueshme me te uleta se vitet paraardhese, dhe investimi ne kompanine XYZ perben tashme mbi 90% te aktiveve neto te kompanise. Kompania XYZ eshteaudituar nga nje firme tjeter audituese, e cila nuk eshte pjese e rrjetit tone, dhe audituesve u eshte mohuar aksesi ne drejtimin dhe audituesit e kompanise. Audituesit arriten ne perfundimin se impakti i anomalise eshte njekohesisht material dhe i perhapur. Materialiteti i audituesve i percaktuar eshte per 31 dhjetor 2013eshte 100mln leke. Totali i

aktiveve ne Bilanc per 31 dhjetor 2013 jane 125 mln leke ndersa ne 31 dhjetor 2012 jane 150 mln leke.

**Pyetje:**

- Përcaktoni se çfare tipi opinionit do te leshojne audituesit drejtimit? Çfare do te shkruhet ne paragrafin e tyre te raportit te auditimit? (5 pikë)

**Përgjigja:**

Investimi ne sipermarrjen e perbashket eshte afersisht **90% \* 125 mln ALL = 112.5 mln ALL**. E cila eshte ne menyre te ndjeshme me e madhe se materialiteti = 100 mln ALL. (0.5 pikë) Impakti eshte dhe **material dhe pervasive ose i perhapur** nisur nga natyra dhe shtrirja e transaksionit. (0.5 pikë). Tipi i opinionit te leshuar do jete **Disclaimer** ose **Refuzim dhenie opinionit**. (0.5 pikë) Ajo çfare do shkruhet ne paragrafin e raportit te auditimit eshte si me poshte vijon:

*Përgjegjësia e audituesit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion në këto pasqyra financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Megjithatë, për **shkak të çeshtjes së përshkruar në paragrafin e bazës për refuzimin e opinionit (0.5 pikë)**, ne nuk ishim në gjendje të siguronim **evidencën e nevojshme (0.5 pikë)** të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit.

*Baza për refuzimin e dhënies së opinionit*

Investimi i ABC shpk në sipërmarrjen e përbashkët me kompaninë XYZ është pasqyruar në shumën 112,500 mije leke në Bilancin Kontabël të kompanisë, i cila përfaqëson më shumë se 90% të aktiveve neto të kompanisë më datën 31 Dhjetor 2013. **Ne nuk na u lejua aksesit (0.5 pikë)** tek drejtimi dhe tek audituesit e kompanisë XYZ, duke përfshirë edhe aksesin në dokumentacionin e auditimit të XYZ. **Si rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të kishte qenë e nevojshme të bëhej ndonjë korigjim në lidhje me pjesën proporcionale të kompanisë për aktivet e XYZ (0.5 pikë)**, që kontrollohet bashkërisht, me pjesën proporcionale të kompanisë për **detyrimet e XYZ**, për të cilat është bashkërisht përgjegjëse, si dhe me pjesën proporcionale të kompanisë **për të ardhurat dhe shpenzimet** e XYZ për vitin, dhe elementët që përbëjnë pasqyrën **e ndryshimeve në kapitalet e veta dhe pasqyrën e fluksese të parasë (0.5 pikë)**.

*Refuzimi i dhënies së opinionit (0.5 pikë)*

Për **shkak të rëndësisë së çeshtjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për refuzimin e dhënies së opinionit (0.5 pikë)**, ne **nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme (0.5 pikë)** të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare.

## **SEKSIONI V: SNAR, SNSL, SNAS**

1. Kur përdor punën e një eksperti profesionisti i praktikës duhet të sigurojë evidencën e nevojshme, që tregojnë se puna e ekspertit është e kënaqshme për qëllimet e angazhimit të dhënies së sigurisë. Cilat janë ato aspekte që duhet të vlerësojë profesionisti për të çmuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës të siguruar nga eksperti. **(4 pikë)**

### **Përgjigja:**

Per të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës të siguruar nga eksperti, profesionisti i praktikës vlerëson:

- (a) Kompetencën profesionale, përfshirë *eksperiencën* dhe *objektivitetin* e ekspertit; **(1,3 pikë)**
  - (b) Sa të arsyeshme janë *supozimet*, *metodat* dhe *të dhënat bazë* të përdorura nga eksperti; **(1.5 pikë)**
  - (c) Sa të arsyeshme dhe domethënëse janë rezultatet e ekspertit në lidhje me *rrethanat* e angazhimit dhe *konkluzionet e profesionistit* të praktikës. **( 1.2 pikë)**
2. Cili është qëllimi i raportit që përgatitet për një angazhim me procedura të rëna dakord? Përmendni elementet që duhet të përmbajë ky raport. **(5 pikë)**

### **Përgjigja:**

Raporti mbi një angazhim me procedura të rëna dakord nevojitet të përshkruajë qëllimin dhe procedurat e rëna dakord të angazhimit me detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar lexuesit të kuptojë natyrën dhe shtrirjen e punës së kryer.

Raporti i fakteve të gjetura përmban:

- (a) titullin;
- (b) të adresuarin (si në përgjithësi, klientin, i cili angazhoi audituesin të kryejë procedura të rëna dakord);
- (c) identifikimin e informacioneve financiare dhe jo-financiare specifike, mbi të cilët janë zbatuar procedurat e rëna dakord;
- (d) një theksim, se procedurat e kryera janë ato, për të cilat është rënë dakord me të interesuarin;
- (e) një theksim, se angazhimi u krye në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit të zbatueshëm në angazhimet me procedura të rëna dakord, ose me standardet ose praktikat kombëtare përkatëse;
- (f) një deklaram, kur është rasti, se audituesi nuk është i pavarur nga entiteti;

- (g) identifikimi i qëllimit, për të cilin janë kryer proçedurat e rëna dakord;
- (h) një listë e proçedurave të veçanta të kryera;
- (i) një përshkrim i fakteve të gjetura nga audituesi, duke përfshirë detaje të mjaftueshme të gabimeve dhe përjashtimeve të gjetura;
- (j) një deklaratë, se proçedurat e kryera nuk përbëjnë as auditim dhe as ekzaminim dhe, se si rrjedhim asnjë siguri nuk është shprehur;
- (k) një deklaratë, se nëse audituesi do të kishte kryer proçedura shtesë, një auditim ose ekzaminim, çështje të tjera mund të ishin shfaqur dhe raportuar;
- (l) një deklaratë, se raporti kufizohet për përdorim për ato palë që kanë rënë dakord për proçedurat e kryera;
- (m) një theksim (kur është rasti), se raporti lidhet vetëm me elementët, llogaritë, çështjet, ose me informacionet financiare dhe jo-financiare specifike dhe se ai nuk shtrihet mbi pasqyrat financiare të entitetit të marra si një e tërë;
- (n) datën e raportit;
- (o) adresën e audituesit; dhe
- (p) firmën e audituesit.

**Suksese!**